

Alfred Halili

MBROJTJA KUSHTETUESE E LIRISË SË SHPREHJES NË SHTETET E BALLKANIT
PERËNDIMOR

Abstrakti

Liria e shprehjes në ditët e sotme paraqitet si ndër liritë më të rëndësishme që njerëzit posedojnë në një shoqëri demokratike. Shfrytëzimi i kësaj të drejte nga qytetarët e secilit shtet përbën pikënisjen e ndërtimit të demokracisë së atij vendi, andaj çdo shtet dhe shoqëri që pretendon të ndërtojë një shtet funksional, të drejtë, ligjor e demokratik, obligohet të krijojë të gjithë mekanizmat e nevojshëm kushtetues e ligjor për ti mundësuar çdo qytetari që të shprehet lirshëm. Si shumë liri, edhe liria e shprehjes domosdo kufizohet nga liritë e tjera, përkatësisht nga e drejta dhe detyrimi që të mbrohen liritë e tjera dhe të tjerëve, nga cenimi që shfrytëzimi i gabuar i lirisë së shprehjes mund të ju bëjë lirive të tjera. Me qëllim të mbrojtjes së lirisë së shprehjes, por edhe mbrojtjes së shoqërisë nga keqpërdorimi i lirisë së shprehjes, shtetet duhet të krijojnë mekanizma kushtetues dhe ligjor për të mundësuar mbrojtjen e lirisë së shprehjes. Duke qenë se liria e shprehjes është një e drejtë kushtetuese, atëherë kërkohet që kjo e drejtë të ketë edhe mbrojtje kushtetuese, e cila mundësohet përmes ndërtimit të institucioneve kompetente që do të kujdesen që kjo e drejtë, përkatësisht kjo liri e shprehjes të mos i cenohet e as tjetërsohet asnjë njeriu, për asnjë arsye të papërcaktuar në mënyrë të arsyeshme ligjore. Shtetet e Ballkanit Perëndimor të përballura me shoqëri që ende janë në fazat finale të tranzicionit demokratik, kanë detyrimin për të avancuar sa më shumë lirinë e shprehjes dhe për të vendosur këtë të drejtë në një fuqi për zhvillimin e tyre demokratik dhe prosperitetin shoqëror, andaj edhe duhet të krijojnë të gjitha instrumentet e nevojshme me qëllim që liria e shprehjes të jetë e garantuar dhe e mbrojtur.

Fjalë kyçe: liria e shprehjes, fjala e lirë, demokracia, mbrojtja dhe kufizimi kushtetues.